

VENDIM
Nr. 44, datë 15.3.2019

**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 13 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 15.3.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Enrgy Trading” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 17, datë 18.2.2019, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 32/4 prot., datë 18.2.2019, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 93/2 prot., datë 20.2.2019, dërgoi pranë subjektit njoftimin e vendimit, dhe bëri me dije mungesën e dokumentacionit të konstatuar në aplikim.

- Rezulton se mbas përfundimit të afateve të pritjes së komenteve dhe opinioneve nuk ka komente apo sugjerime në lidhje me këtë aplikim.

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93/3, datë 4.3.2019, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.7 dhe 4.7.1) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT**

Erjola Sadushi